



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 56 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10 dhe nenit 6 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/ 111-400, Kryetari i komunës së Podujevës, merr:

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR MBËSHTETJE DHE OFRIM TË NDIHMAVE NGA KATEGORIA E MJETEVE BUXHETORE SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Neni 1

Për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, ngritet Komisioni në këtë përbërje:

1. Ylber Salihu, kryesues
2. Fitim Bunjaku, anëtar

Anëtar i tretë i Komisionit, varësisht kërkesave të paraqitura Drejtorive përkatëse, është:

1. Xhevat Llugaliu, Drejtoria e Arsimit
2. Zenel Zeneli, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mëirëqenjes Sociale
3. Agim Idrizi, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
4. Behë Govori, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Mandati i Komisionit është deri më 31 dhjetor 2017.


Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me nenin 7 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferte.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-020/04-5017/17
Podujevë,
30 janar 2017



Kryetari i Komunës
Agim Veliu